

ELITE URBAN DEVELOPMENT SH.P.K.
TIRANE Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 4, Ap 26
NUIS L62423019U

Per: Qendren Kombetare te Regjistrimit

DEKLARATE: MBI ARSYEN E HAPJES SE CESHTJES

Sot, më datë 07.09.2022, unë, nënshkruara Dafina Keçi, shtetase shqiptare, e lindur më 31.05.1985 në Bajram Curri, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 033740933, dhe me numër personal I55531071U në cilësinë e administratorit të shoqërisë Elitë Urban Development sh.p.k NUIS L62423019U,

Deklaroj:

Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit date 01.09.2022 per miratimin e zvogelimit te kapitalit te shoqerise.

Vlera e Kapitalit total i shoqerise ishte ("1,334,271,648 LEK") Lek, i ndare respektivisht kontribut ne para ne vleren prej ("900.100,00") Lek dhe kontribut ne natyre ne vleren prej ("1,333,371,548") Lek

u bë

Vlera e Kapitalit total i shoqerise ("1,216,391,824") Lek, i ndare respektivisht ne kontribut ne para ne vleren prej ("900.100,00") Lek dhe kontribut ne natyre ne vleren prej (" 1,215,491,724 ") Lek.

ELITE URBAN DEVELOPMENT SH.P.K.

Znj. Dafina Keçi

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ELITE URBAN DEVELOPMENT SH.P.K.
Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me
NUIS L62423019U
Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 4, Ap 26, Tirane

VENDIM

I

ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 01.09.2022 (dy mijë e njëzet e dy), në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë Elite Urban Development Sh.p.k me NUIS **L62423019U** (më tej referuar si "SHOQËRIA"), u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Shoqëria "Tirana Logistic Park" Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Autostrada Tiranë – Durrës, Km. 5, Rruga "Gryka e Kaçanikut", mbrapa fabrikës Coca - Cola, Kamëz, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K81715012B, përfaqësuar nga administratori Znj. Irta Xhahysa, shtetase shqiptare, lindur në Kavajë, më 01.09.1991, me numër personal J15901111E, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, Ortake e Vetme e Shoqërisë, zoteruese e një kuote që perben 100% të pjesëmarrjes në Shoqëri.

Kryetari i Asamblesë znj. Irta Xhahysa deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. **ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË;**
- II. **TE NDRYSHME;**

- I. **ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

NË LIDHJE ME PIKËN E PARË NË REND TË DITËS, Ortaku i Vetëm parashtron se Kapitali aktual i Shoqërisë është **1,334,271,648 LEK (Një miliardë e treqind e tridhjetë e katër milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë lekë)**.

Aktualisht Shoqëria ka miratuar pasqyrat financiare të shoqërisë "Elite Urban Development" Sh.p.k për vitin financiar 2021 (dy mijë e njëzet e një) ku është vendosur që vlera totale e humbjes prej **469,824 LEK (katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e kater lekë)** do të mbulohet nga kapitali aksionar i Shoqërisë, sipas vendimit me të dhënat si më poshtë:

- Vendimi datë **27.06.2022 (dy mijë e njëzet e dy)** që miraton mbulimin e humbjes në vlerën prej **469,824 LEK (katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e kater lekë)** nga kapitali aksionar i shoqërisë; Ky Vendim është depozituar në regjister më datë 07.07.2022 sëbashku me Depozitimin e Pasqyrave Financiare 2021 (dy mijë e njëzet e një), të cilat janë miratuar nga QKB-ja.



Gjithashtu për motive operacionale është parë e arsyeshme dhe propozohet zvogëlimi i kapitalit me 1,000,000 EUR (një milion euro) ose kundërvlehtë në **117,410,000 LEK (Njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e katerqind e dhjetë mijë lekë)**. Pas zvogëlimit, kapitali i Shoqërisë nga vlera 1,333,801,824 LEK (Një miliardë e treqind e tridhjetë e tre milion e teteqind e një mijë e tetëqind e njëzetë e katër lekë) - vlerë nga e cila është zbritur paraprakisht vlera prej **469,824 LEK (katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e kater lekë)** sipas vendimit më sipër, do të bëhet në një vlerë prej **1,216,391,824 LEK (Një miliard e dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e nentëdhjetë e një mijë e tetë qind e njëzetë e katër lekë)**.

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOS:

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me **117,410,000 LEK (Njëqindë e shtatëmbëdhjetë milion e katerqindë e dhjetë mijë lekë)**, ne vijim te zbritjes se bere paraprakisht te kapitalit si me sipër;
- B. Kapitali i ri i shoqërisë do të jetë **1,216,391,824 LEK (Një miliard e dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion e treqind e nentëdhjetë e një mijë e tetë qind e njëzetë e katër lekë)**;
- C. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme online me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, Ortaku i vetëm deklaron të mbyllur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në orën 11:00.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

ELITE URBAN DEVELOPMENT SH.P.K

Me ortak te vetëm

TIRANA LOGISTIC PARK SH.P.K.

Irta Xhahysa


